ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **652-26-7895-2-2-1**
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: **Hartimi i Projekteve për Komunën e Kaçanikut**
(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Al Group PRO SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Sëiss Village nr,7
(Adresa)

Prishtinë — **10000**
(Vendi) — *(Kodi postar)*

04945 2222 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Gezim Sylaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

algroup.pro.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

27.11.2026
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.
Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontrate i datës **18.09.2026**
- Data e dorezimit te tenderit **19.10.2026**
- Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues **13.11.2026**
- Kerkesa per rishqyrtim: **18.11.2026**
- Pergjigjia e kerkeses per rishqyrtim: **20.11.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja na është dërguar përmes platëformes elektronike E-Prokurimi

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*
A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se. • Zyra e

Prokurimit e Autoritetit Kontraktues – KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK, me datë 13.11.2026 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.Pas publikimit të këtij njoftimi, operatori ekonomik ka parashtruar kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Në kuadër të kësaj kërkese, na është mundësuar qasja në dokumentacionin të procedurës së prokurimit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, duke paraqitur pretendimet tona lidhur me vlerësimin e ofertave dhe zbatimin e dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik. Megjithatë, me vendim të Autoritetit Kontraktues, kërkesa jonë për rishqyrtim është refuzuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 i LPP: Qëllimi
- Neni 7 i LPP: Barazia në trajtim jo diskriminimi
- Neni 28 Specifikimet teknike
- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 57 Sigurimi i Tenderit
- Neni 60 i LPP: Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 64 i LPP:Dëshmitë e kërkesave
- Neni 65 i LPP: Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
- Neni 66 i LPP: Përshtatshmëria Profesionale
- Neni 69 i LPP: Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Udhëzues Nr.001/2023 për Prokurimin Publik-10-Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve Rregulloren nenin-17-Dosja e tenderit pika 17.11
Neni 41-Te Rregullores per prokurimin publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kënaqur me njoftimin e date **13.11.2026** mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK brenda ne afatin ligjor konform ligjit, ushtrojmë këtë:

A N K E S Ë

Për shkak se AK- KUVENDI I KOMUNES – KAÇANIK

1. Në mënyrë te kundërligjshme ka shpallur fituese Kompaninë e cila është dashur të eliminohet pasi që nuk janë përmbushur të gjitha kriteret e vlerësimit të vendosura ne Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT.)

N.SH. "3D- PROJECT "

- Në kuadër të kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, konkretisht në pikat 9.1 dhe 9.2, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar angazhimin e një gjeodeti të licencuar (Bachelor ose Master), ku është përcaktuar shprehimisht se inxhinierët e propozuar duhet të posedojnë licencën e kategorisë A. Megjithatë, nga dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë rezulton se gjeodeti i propozuar, Xhavit Fetahu, nuk posedon licencën e kategorisë A, ashtu siç kërkohet shprehimisht në Dosjen e Tenderit. Rrjedhimisht, operatori ekonomik nuk e ka përmbushur një nga kërkesat e detyrueshme të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike, pasi dokumentacioni i paraqitur nuk dëshmon plotësimin e kriterit të përcaktuar nga vetë Autoriteti Kontraktues. Kjo çështje është trajtuar edhe në Vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së, nr. 782/26, i cili duhet të merret në konsideratë gjatë vlerësimit të këtij kriteri. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të zbatojë në mënyrë të barabartë dhe të njëjtë kërkesat e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit për të gjithë operatorët ekonomikë, pa bërë interpretime selektive apo përjashtime nga kriteret e përcaktuara.

Për këtë arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë dosjen e tenderit, pasi që gjeodeti i propozuar nuk posedon licencën e kategorisë A, duke ndërmarrë veprimet përkatëse në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Dosjen e Tenderit.

- Gjatë qasjes në dokumentet zyrtare të tenderit, kemi konstatuar se më datë 30.10.2026, Autoriteti Kontraktues i ka dërguar operatorit ekonomik 3D Project Letrën Standarde për Kërkesën për Informata lidhur me Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, duke kërkuar sqarime për të gjitha pozicionet e ofertës së tij.Nga shqyrtimi i përgjigjes së dorëzuar nga ky operator ekonomik, kemi vërejtur se është paraqitur një analizë e detajuar për secilin pozicion, duke përfshirë ndarjen e çmimeve dhe sasive përkatëse. Megjithatë, konsiderojmë se një analizë e tillë, e paraqitur vetëm në formë të përllogaritjeve dhe ndarjes së çmimeve, nuk përbën dëshmi konkrete dhe bindëse për të vërtetuar se çmimet e ofertuar janë reale, të qëndrueshme dhe të mjaftueshme për realizimin e plotë të kontratës. Theksojmë se çmimet e ofruara nga operatori ekonomik 3D Project janë të ulëta dhe, sipas vlerësimit tonë, në kundërshtim me kërkesat dhe parimet e përcaktuara në nenin 41 lidhur me tenderët jo-normalisht të ulët. Në këtë drejtim, nuk mjafton që operatori ekonomik të paraqesë një tabelë apo analizë të brendshme të kostove, por duhet të dëshmojë në mënyrë objektive dhe të verifikueshme se si mund t'i realizojë punët me çmimet e ofruara, pa cenuar cilësinë, specifikimet teknike, standardet e kërkuara dhe afatet e realizimit të kontratës. Për më tepër, vetë fakti se operatori ekonomik ka bërë ristrukturimin dhe ndarjen e çmimeve vetëm pas kërkesës së Autoritetit Kontraktues për sqarim, ngre dyshime serioze lidhur me bazueshmërinë e kësaj analize. Një analizë e tillë nuk mund të merret automatikisht si dëshmi e kostove reale, veçanërisht kur nuk dëshmohet se çmimet e paraqitura mbështeten në oferta konkrete nga furnitorët, çmime reale të materialeve, kosto të fuqisë punëtore, shpenzime të makinerive, transportit, pajisjeve dhe shpenzimeve të tjera të domosdoshme për realizimin e punëve. Gjithashtu, vërejmë se në analizën e paraqitur janë përfshirë edhe sasi dhe përllogaritje të cilat nuk rezultojnë të jenë të parapara në mënyrë të qartë në dokumentacionin fillestar të ofertës, çka kërkon një verifikim të veçantë nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues është dashur të analizojë nëse kjo ndarje e mëvonshme përputhet plotësisht me çmimet njësi, sasitë dhe vlerat e ofertës fillestare, apo nëse përmes saj janë krijuar përllogaritje të reja, të cilat nuk pasqyrojnë përmbajtjen reale të ofertës së dorëzuar në afatin e tenderimit.
  Në këtë kontekst, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur nevojë të kërkojë informata shtesë në mënyrë të përgjithshme për të gjitha pozicionet, nëse nga shqyrtimi i ofertës fillestare ishte e qartë se çmimet e ofruara ishin jo-normalisht të ulëta dhe nuk ishin të mbështetura në një strukturë të besueshme të kostove. Kërkesa për sqarim, në rastet kur aktivizohet procedura për tenderët jo-normalisht të ulët, nuk duhet të shndërrohet në mundësi për operatorin ekonomik që të krijojë apo riformulojë pas dorëzimit të ofertës një strukturë të re çmimesh, por duhet të shërbejë vetëm për të shpjeguar dhe dëshmuar bazueshmërinë e çmimeve të ofertuar fillimisht. Prandaj, Autoriteti Kontraktues është dashur të bëjë një vlerësim real, objektiv dhe të dokumentuar të çmimeve fillestare, duke i krahasuar ato me analizën e dorëzuar, me çmimet e tregut dhe me kostot reale të nevojshme për realizimin e secilit pozicion. Vetëm paraqitja e një analize të përgatitur nga vetë operatori ekonomik nuk e obligon Autoritetin Kontraktues që ta pranojë atë si të mirëqenë, pa verifikuar saktësinë dhe besueshmërinë e saj. Në mungesë të dëshmive objektive dhe bindëse, kjo përgjigje nuk mund të konsiderohet arsyetim i mjaftueshëm për një ofertë me çmime jo-normalisht të ulëta. Konsiderojmë se pranimi i një oferte të tillë vetëm mbi bazën e një analize të brendshme, pa verifikim të kostove reale dhe pa dëshmi të mjaftueshme, cenon transparencën, trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore për prokurimin publik.

- **GEOPLAN&CONSULTING GROUP SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK**

Në kuadër të kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, konkretisht në pikat 9.1 dhe 9.2, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar angazhimin e një gjeodeti të licencuar (Bachelor ose Master), duke përcaktuar shprehimisht se inxhinierët e propozuar duhet të posedojnë **licencën e kategorisë A.**Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë **GEOPLAN & CONSULTING GROUP SH.P.K. dhe STUDIO HAPSIRA SH.P.K.,** rezulton se gjeodeti i propozuar, z. **Besart HALIMI,** nuk posedon licencën e kategorisë A, ashtu siç është kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues. Rrjedhimisht, dokumentacioni i dorëzuar nga ky grup i operatorëve ekonomikë nuk dëshmon përmbushjen e njërit prej kritereve të detyrueshme të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike. Në këtë rast, nuk bëhet fjalë për një mangësi formale apo dokumentare, por për mungesën e dëshmisë së një kualifikimi profesional të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit. Theksojmë se kjo çështje është trajtuar edhe në Vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së, nr. 782/26**,** i cili duhet të merret në konsideratë gjatë shqyrtimit të këtij kriteri, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i drejtë dhe i njëtrajtshëm i kërkesave të prokurimit. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit t'i zbatojë në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pa interpretime selektive, tolerime apo përjashtime që do të cenonin parimin e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Përfundimisht, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishqyrtojë vlerësimin e dokumentacionit të këtij grupi të operatorëve ekonomikë dhe të konstatojë se kriteri i përcaktuar në pikat 9.1 dhe 9.2 nuk është përmbushur, pasi gjeodeti i propozuar nuk dëshmon posedimin e licencës së kategorisë A. Për rrjedhojë, kërkojmë që të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore dhe të mos rekomandohet për kontratë një operator ekonomik i cili nuk i përmbush kërkesat e detyrueshme të Dosjes së Tenderit**.**

- **F&A Consulting SHPK & Revivo Group L.L.C**

Në kuadër të kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, konkretisht në pikat 9.1 dhe 9.2, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar angazhimin e një gjeodeti të licencuar (Bachelor ose Master), duke përcaktuar shprehimisht se inxhinierët e propozuar duhet të posedojnë licencën e kategorisë A.
Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë F&A Consulting SH.P.K. & Revivo Group L.L.C., rezulton se gjeodeti i propozuar, z. Agron Shabani, nuk posedon licencën e kategorisë A, ashtu siç është kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues.
Rrjedhimisht, dokumentacioni i dorëzuar nga ky grup i operatorëve ekonomikë nuk dëshmon përmbushjen e njërit prej kritereve të detyrueshme të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike. Në këtë rast, nuk bëhet fjalë për një mangësi thjesht formale apo dokumentare, por për mungesën e dëshmisë së një kualifikimi profesional të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.
Theksojmë se kjo çështje është trajtuar edhe në Vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së, nr. 782/26, i cili duhet të merret në konsideratë gjatë shqyrtimit të këtij kriteri, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i drejtë dhe i njëtrajtshëm i kërkesave të prokurimit.
Për më tepër, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit t'i zbatojë në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pa interpretime selektive, tolerime apo përjashtime që do të cenonin parimin e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
Përfundimisht, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishqyrtojë vlerësimin e dokumentacionit të këtij grupi të operatorëve ekonomikë dhe të konstatojë se kriteri i përcaktuar në pikat 9.1 dhe 9.2 nuk është përmbushur, pasi gjeodeti i propozuar nuk dëshmon posedimin e licencës së kategorisë A. Për rrjedhojë, kërkojmë që të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore dhe të mos rekomandohet për kontratë një grup i operatorëve ekonomikë i cili nuk i përmbush kërkesat e detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

- **ARTINGS PROJECT SHPK & NIL ENGINEERING SHPK**

Në kuadër të kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, konkretisht në pikat 9.1 dhe 9.2, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar angazhimin e një gjeodeti të licencuar (Bachelor ose Master), duke përcaktuar shprehimisht se inxhinierët e propozuar duhet të posedojnë licencën e kategorisë A. Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë ARTINGS PROJECT SH.P.K. & NIL ENGINEERING SH.P.K., rezulton se gjeodeti i propozuar, z. Rinor Krasniqi, nuk posedon licencën e kategorisë A, ashtu siç është kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues. Rrjedhimisht, dokumentacioni i dorëzuar nga ky grup i operatorëve ekonomikë nuk dëshmon përmbushjen e njërit prej kritereve të detyrueshme të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike. Në këtë rast, nuk bëhet fjalë për një mangësi thjesht formale apo dokumentare, por për mungesën e dëshmisë së një kualifikimi profesional të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.
Theksojmë se kjo çështje është trajtuar edhe në Vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së, nr. 782/26, i cili duhet të merret në konsideratë gjatë shqyrtimit të këtij kriteri, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i drejtë dhe i njëtrajtshëm i kërkesave të prokurimit.
Për më tepër, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit t'i zbatojë në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pa interpretime selektive, tolerime apo përjashtime që do të cenonin parimin e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Përfundimisht, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishqyrtojë vlerësimin e dokumentacionit të këtij grupi të operatorëve ekonomikë dhe të konstatojë se kriteri i përcaktuar në pikat 9.1 dhe 9.2 nuk është përmbushur, pasi gjeodeti i propozuar nuk dëshmon posedimin e licencës së kategorisë A. Për rrjedhojë, kërkojmë që të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore dhe ky grup i operatorëve ekonomikë të mos rekomandohet për kontratë, për shkak të mospërmbushjes së kërkesave të detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

- **N.N.SH Vision Project**

Në kuadër të kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, konkretisht në pikat 9.1 dhe 9.2, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar angazhimin e një gjeodeti të licencuar (Bachelor ose Master), duke përcaktuar shprehimisht se inxhinierët e propozuar duhet të posedojnë licencën e kategorisë A. Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik VISION PROJECT, rezulton se gjeodeti i propozuar, z. Esmir Arifi, nuk posedon licencën e kategorisë A, ashtu siç është kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues. Rrjedhimisht, dokumentacioni i dorëzuar nga ky operator ekonomik nuk dëshmon përmbushjen e njërit prej kritereve të detyrueshme të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike. Në këtë rast, nuk bëhet fjalë për një mangësi thjesht formale apo dokumentare, por për mungesën e dëshmisë së një kualifikimi profesional të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.
Theksojmë se kjo çështje është trajtuar edhe në Vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së, nr. 782/26, i cili duhet të merret në konsideratë gjatë shqyrtimit të këtij kriteri, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i drejtë dhe i njëtrajtshëm i kërkesave të prokurimit. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit t'i zbatojë në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pa interpretime selektive, tolerime apo përjashtime që do të cenonin parimin e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Përfundimisht, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishqyrtojë vlerësimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik VISION PROJECT dhe të konstatojë se kriteri i përcaktuar në pikat 9.1 dhe 9.2 nuk është përmbushur, pasi gjeodeti i propozuar nuk dëshmon posedimin e licencës së kategorisë A. Për rrjedhojë, kërkojmë që të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore dhe operatori ekonomik të mos rekomandohet për kontratë, për shkak të mospërmbushjes së kërkesave të detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

- **FST Engineering SHPK & AL Engineering SHPK**

Në kuadër të kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, konkretisht në pikat 9.1 dhe 9.2, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar angazhimin e një gjeodeti të licencuar (Bachelor ose Master), duke përcaktuar shprehimisht se inxhinierët e propozuar duhet të posedojnë licencën e kategorisë A. Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë FST Engineering SH.P.K. & AL Engineering SH.P.K., rezulton se gjeodeti i propozuar, z. Suad Çmega, nuk posedon licencën e kategorisë A, ashtu siç është kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues. Rrjedhimisht, dokumentacioni i dorëzuar nga ky grup i operatorëve ekonomikë nuk dëshmon përmbushjen e njërit prej kritereve të detyrueshme të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike. Në këtë rast, nuk bëhet fjalë për një mangësi thjesht formale apo dokumentare, por për mungesën e dëshmisë së një kualifikimi profesional të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit. Theksojmë se kjo çështje është trajtuar edhe në Vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së, nr. 782/26, i cili duhet të merret në konsideratë gjatë shqyrtimit të këtij kriteri, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i drejtë dhe i njëtrajtshëm i kërkesave të prokurimit.
Për më tepër, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit t'i zbatojë në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pa interpretime selektive, tolerime apo përjashtime që do të cenonin parimin e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
Përfundimisht, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishqyrtojë vlerësimin e dokumentacionit të këtij grupi të operatorëve ekonomikë dhe të konstatojë se kriteri i përcaktuar në pikat 9.1 dhe 9.2 nuk është përmbushur, pasi gjeodeti i propozuar nuk dëshmon posedimin e licencës së kategorisë A. Për rrjedhojë, kërkojmë që të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore dhe ky grup i operatorëve ekonomikë të mos rekomandohet për kontratë, për shkak të mospërmbushjes së kërkesave të detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

- **ZeroLine SHPK**

Në kuadër të kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, konkretisht në pikat 9.1 dhe 9.2, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar angazhimin e një gjeodeti të licencuar (Bachelor ose Master), duke përcaktuar shprehimisht se inxhinierët e propozuar duhet të posedojnë licencën e kategorisë A. Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ZEROLINE SH.P.K., rezulton se gjeodeti i propozuar, z. Fisnik Ismaili, nuk posedon licencën e kategorisë A, ashtu siç është kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues. Rrjedhimisht, dokumentacioni i dorëzuar nga ky operator ekonomik nuk dëshmon përmbushjen e njërit prej kritereve të detyrueshme të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike. Në këtë rast, nuk bëhet fjalë për një mangësi thjesht formale apo dokumentare, por për mungesën e dëshmisë së një kualifikimi profesional të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.
Theksojmë se kjo çështje është trajtuar edhe në Vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së, nr. 782/26, i cili duhet të merret në konsideratë gjatë shqyrtimit të këtij kriteri, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i drejtë dhe i njëtrajtshëm i kërkesave të prokurimit. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit t'i zbatojë në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pa interpretime selektive, tolerime apo përjashtime që do të cenonin parimin e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
Përfundimisht, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishqyrtojë vlerësimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik ZEROLINE SH.P.K. dhe të konstatojë se kriteri i përcaktuar në pikat 9.1 dhe 9.2 nuk është përmbushur, pasi gjeodeti i propozuar nuk dëshmon posedimin e licencës së kategorisë A. Për rrjedhojë, kërkojmë që të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore dhe operatori ekonomik të mos rekomandohet për kontratë, për shkak të mospërmbushjes së kërkesave të detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

- **KUBE SHPK & DEA GROUP SHPK**

Në kuadër të kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, konkretisht në pikat 9.1 dhe 9.2, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar angazhimin e një gjeodeti të licencuar (Bachelor ose Master), duke përcaktuar shprehimisht se inxhinierët e propozuar duhet të posedojnë licencën e kategorisë A. Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë KUBE SH.P.K. & DEA GROUP SH.P.K., rezulton se gjeodeti i propozuar, z. Durim Hoxha, nuk posedon licencën e kategorisë A, ashtu siç është kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues.
Rrjedhimisht, dokumentacioni i dorëzuar nga ky grup i operatorëve ekonomikë nuk dëshmon përmbushjen e njërit prej kritereve të detyrueshme të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike. Në këtë rast, nuk bëhet fjalë për një mangësi thjesht formale apo dokumentare, por për mungesën e dëshmisë së një kualifikimi profesional të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.
Theksojmë se kjo çështje është trajtuar edhe në Vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së, nr. 782/26, i cili duhet të merret në konsideratë gjatë shqyrtimit të këtij kriteri, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i drejtë dhe i njëtrajtshëm i kërkesave të prokurimit.
Për më tepër, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit t'i zbatojë në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pa interpretime selektive, tolerime apo përjashtime që do të cenonin parimin e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
Përfundimisht, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishqyrtojë vlerësimin e dokumentacionit të këtij grupi të operatorëve ekonomikë dhe të konstatojë se kriteri i përcaktuar në pikat 9.1 dhe 9.2 nuk është përmbushur, pasi gjeodeti i propozuar nuk dëshmon posedimin e licencës së kategorisë A. Për rrjedhojë, kërkojmë që të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore dhe ky grup i operatorëve ekonomikë të mos rekomandohet për kontratë, për shkak të mospërmbushjes së kërkesave të detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

Te gjithe keto shtjellime janë të bazuara edhe në linkun që po bashkangjisim ku deshmohet që stafi i angazhuar nuk posedojnë licencat sipas kerkeses se dosjes se tenderit,
https://oirk.org/wp-content/uploads/2026/08/Regjistri-i-te-gjithe-anetareve-06.08.2026-1-1.pdf
ndersa njekohesesisht kerkojme nga ana juaj si Autoritet Kontraktues që vleresimi të bëhët në bazë të Kritereve te parashtruara në Dosjen e tenderit dhe Njoftimit per kontrate

- Në përgjigjen e dhënë pas refuzimit të kërkesës sonë për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka tentuar të arsyetojë çështjen e licencimit të inxhinierëve të gjeodezisë, duke iu referuar një kërkese për sqarim të parashtruar nga një operator tjetër ekonomik, i cili kishte kërkuar të dijë nëse operatorët ekonomikë duhet të posedojnë patjetër Licencën e Kategorisë A. Përgjigjja e Autoritetit Kontraktues ndaj kësaj kërkese ka qenë se një licencë e tillë nuk është e domosdoshme. Mirëpo, ky sqarim nuk mund të merret si bazë për të ndryshuar, plotësuar apo interpretuar në mënyrë tjetër kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, pasi që çështja e licencimit të inxhinierëve të gjeodezisë rregullohet nga legjislacioni përkatës dhe kompetencat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), e cila është institucioni kompetent për licencimin e profesionistëve të kësaj fushe. Për më tepër, në kuadër të këtij sqarimi, Autoriteti Kontraktues ka bashkëngjitur edhe një listë të distribuimit, nga Zyra e Kryetarit, të cilën e ka përdorur si mbështetje për qëndrimin e tij lidhur me këtë çështje. Në këtë drejtim, theksojmë se Autoriteti Kontraktues nuk mund të krijojë përjashtime nga kërkesat ligjore përmes një përgjigjeje në kërkesë për sqarim, e aq më pak duke u mbështetur në një dokument të brendshëm administrativ. Nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se kërkesa e përcaktuar në Dosjen e Tenderit duhet të ndryshohet, plotësohet apo sqarohet në atë mënyrë që ndikon në kriteret e pjesëmarrjes dhe dokumentacionin e kërkuar nga operatorët ekonomikë, atëherë ka qenë i obliguar të ndjekë procedurën ligjore për ndryshimin formal të dokumenteve të tenderit. Konkretisht, sipas nenit 63, pikës 63.1.3 (b) të Rregullores për Prokurimin Publik, përcaktohet qartë: "Kurdo që miratimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues do të bëjë publikimin e Njoftimit për korrigjim të gabimeve, duke përdorur formularin B54 dhe do të zgjasë afatin e dorëzimit të tenderëve në përputhje me nenin 53 të LPP-së." Megjithatë, në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka publikuar Njoftimin për Korrigjim përmes Formularit B54, nuk ka bërë ndryshimin formal të Dosjes së Tenderit dhe as nuk ka zgjatur afatin e dorëzimit të ofertave në përputhje me dispozitat ligjore. Për rrjedhojë, përgjigjja e dhënë ndaj operatorit tjetër ekonomik nuk mund të konsiderohet si ndryshim zyrtar i Dosjes së Tenderit dhe nuk mund të përdoret si bazë për të ndryshuar kuptimin apo zbatimin e kritereve të përcaktuara në dokumentacionin fillestar. Një veprim i tillë krijon pasiguri juridike dhe cenon parimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, pasi që një operator mund të mbështetet në një sqarim të caktuar, ndërsa operatorët e tjerë vazhdojnë të jenë të detyruar të respektojnë dokumentacionin fillestar të tenderit. Kjo paraqet trajtim jo të barabartë dhe krijon kushte të ndryshme për pjesëmarrësit në të njëjtën procedurë të prokurimit.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues nuk mund të përdorë në fazën e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim një përgjigje të dhënë më herët ndaj një operatori tjetër ekonomik, për të arsyetuar ligjshmërinë e një kriteri apo për të ndryshuar interpretimin e tij, kur vetë Autoriteti Kontraktues nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore për ndryshimin zyrtar të dokumentacionit të tenderit.

Rrjedhimisht, kërkojmë nga OSHP-ja që këtë sqarim dhe dokumentacionin e bashkëngjitur nga Autoriteti Kontraktues të mos i trajtojë si ndryshim të vlefshëm të Dosjes së Tenderit, pasi që nuk është respektuar procedura e përcaktuar me nenin 63.1.3 (b) të Rregullores. Po ashtu, kërkojmë të vlerësohet nëse kërkesa për licencim është përcaktuar në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë gjeodezike dhe nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur bazë ligjore për interpretimin dhe përjashtimin e paraqitur në përgjigjen e tij. Prandaj, bazuar në të gjitha sqarimet, argumentet dhe provat e paraqitura më lart, kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues që, gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, të marrin në konsideratë të gjitha pretendimet tona dhe të konstatojnë shkeljet e evidentuara. Në këtë drejtim, kërkojmë që lënda të kthehet në rivlerësim, si dhe të detyrohet dhe udhëzohet Autoriteti Kontraktues që të bëjë Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve, në përputhje me dispozitat e nenit 59 të LPP-së, si dhe në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e OSHP-së.

Kërkojmë nga OSHP-ja që të marrë vendim me të cilin:

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e kompanisë sonë.

II. ANULOHET Njoftimi i Autoritetit Kontraktues.

III. LËNDA TË KTHEHET NË RIVLERËSIM, duke e duke marrë parasysh të gjitha pretendimet dhe vërejtjet e paraqitura nga ana jonë, nëpërputhje me dispozitat e LPP-së dhe vendimet e OSHP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet mbi angazhimin e stafit, Mundësia e marrjes se punes

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"*
   ****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*